



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Datë: 26.05.2025  
Numër Protokolli: 4226/2025

A.nr.478/2025

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave** në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari, kryetare, Eshref Shabani dhe Ardita Haxhnikaj-Demi, anëtarë, me Atdhe Gashi- në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën A.nr.478/2025 të datës 17.03.2025, të parashtruar nga ankuesi I.E, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Avokat Hajzer Salihu, nga Prishtina, kundër organit të punësimit/Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, në çështjen juridike “*kërkesë nga marrëdhënia e punës*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180 si dhe në mbështetje me dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 26.05.2025, mori këtë:

## V E N D I M

**I. Aprovohet si e bazuar** ankesa me numër A.nr.478/2025, e datës 17.03.2025, e parashtruar nga ankuesi I.E.

**II. Shfuqizohet** Vendimi me Ref.02/ Nr.43, i datës 21.02.2025, i U.D Sekretares së Përgjithshme së Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë.

**III. Obligohet** U.D Sekretarja e Përgjithshme e Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, që të ndërmarrin të gjitha veprimet e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit.

**IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës**, duhet të njoftohet me shkrim për ndërmarrjen e veprimeve në pajtim me këtë vendim.

## A r s y e t i m

Nëpunësi civil, I.E(*në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesi*) përmes përfaqësuesit të autorizuar Avokat Hajzer Salihu, më datë 17.03.2025 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit Ref.02/ Nr.43, të datës 21.02.2025, të U.D Sekretares së Përgjithshme së Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë dhe kundër mos inicimit të procedurave të transferimit sipas procesit të ristrukturimit të Agjencisë për Meteorologji të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli*) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, më datë 07.04.2025 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, ndërsa kjo e fundit më datë 10.04.2025, ka përcjell shkresat e lëndës lidhur me çështjen për vendosje.

Kryetari i Këshillit, pas pranimit të kërkesës së kryetares së Kolegjit për Shqyrtimin dhe Vendosjes së Ankesave, me Vendimin me numër VK/2025 dhe numër të protokollit 2889/2025 të datës 30.04.2025, ka shtyrë afatin për vendosje të ankesës së parashtruar nga ankuesi edhe për dhjetë (10) ditë pune. Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (*në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit*) pas konstatimit se ankesa është e pranueshme në kuptim të dispozitave të nenit 129 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, vendosi për shqyrtimin e të njëjtës, kështu që për vendosje meritorë administroi këto prova: Ankesën me numër protokolli 1730/2025 të datës 17.03.2025, të parashtruar nga ankuesi në Këshill; Vendimin me Ref.02/Nr.43 të datës 21.02.2025; Vendimin me Ref.02/Nr.91 të datës 14.03.2022; Akt emërimit të datës 09.07.2012 dhe përshkrimin e detyrave të punës; Kërkesën për përgjigje në ankesë; Përgjigjen në ankesë të datës 10.04.2025; Vendimin Nr.02 Ref.300 të datës 30.09.2013; Kërkesën për avancim të datës 30.09.2013; Pëlqimin e datës 30.09.2013; Akt emërimit të datës 16.12.2019; Formularin e vlerësimit të rezultateve të punës të datës 18.02.2025, të datës 29.02.2024, të datës 24.01.2023, të datës 31.01.2022, të datës 01.02.2021; Listat e pagave të ankuesit.

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, ka gjetur se ankesa është e bazuar, **sepse:**

Nga administrimi i shkresave të lëndës, rezulton se ankuesi sipas Akt emërimit të datës 09.07.2012, ushtron pozitën e punës *Udhëheqës i Divizionit të Metrologjisë* në Departamentin e Metrologjisë-Agjencia për Meteorologji e Kosovës , në kuadër të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë.

Ankuesi, në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon se Vendimi me Ref.02/ Nr.43, të datës 21.02.2025, i U.D Sekretares së Përgjithshme së Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, është nxjerrë në kundërshtim me dispozitat ligjore të nenit 19 paragrafit 4 të Ligjit Nr.06/L-116 për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratës, Shtetërore dhe nenin 35 paragrafin 2 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik, ashtu që ka kërkuar nga Këshilli aprovimin e ankesës dhe anulimin e aktit kontestues, me obligimin ligjor që Sekretarja e Përgjithshme e organit përkatës të punësimit, të ndërmerr të gjitha veprimet ligjore në kuptim të nenit 66 të Ligjit për Zyrtarët Publik, duke i mundësuar ankuesit që përmes një procesi të

ligjshëm të rregullohet statusi i tij, duke e sistemuar në pozitë ekuivalente me Akt emërimin e datës 09.07.2012.

Kolegji i Këshillit, me qëllim të shqyrtimit të pretendimeve ankimore të ankuesit, ka analizuar Vendimin me Ref.02/Nr.43 të datës 21.02.2025, të U.D Sekretares së Përgjithshme të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, përmes të cilit znj. S.A-Z, Zyrtare për Metrologji është caktuar Ushtruese e Detyrës e Drejtorit të Departamentit të Metrologjisë Ligjore në Agjencinë e Metrologjisë së Kosovës, si rrjedhojë Kolegji i Këshillit, konstaton se i njëjti akt është nxjerrë në kundërshtim me dispozitat e aplikueshme ligjore që rregullojnë caktimin e ushtruesve të detyrës, gjegjësisht në kundërshtim me paragrafin 1 dhe 2 të nenit 35 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, i cili përcakton se: “1.Në rast se një pozitë e nivelit drejtues brenda strukturës organizative të institucionit mbetet e lirë, nëpunësja/i i nivelit të lartë drejtues e atij institucioni e cakton me vendim ushtruesen/in e detyrës për pozitën e lirë. 2. Në pajtim me paragrafin 1. të këtij neni, ushtruesja/i i detyrës mund të caktohet zyrtarja/imë i lartë i kategorisë pasuese, në vartësi të pozitës që caktohet, nga cilado njësi organizative brenda institucionit”, ngase në rastin konkret është dashur të caktoj një zyrtar të lartë nga kategoria pasuese, apo thënë më konkretisht një zyrtarë që mbanë pozitën e kategorisë së ulët drejtuese, respektivisht Udhëheqës i Divizionit me Akt emërim, nga cilado njësi organizative brenda Agjencisë së Metrologjisë së Kosovës, ndërsa në rastin konkret dhe mbi dëshmitë e paraqitura si më sipër rezulton se znj. S.A-Z, ka kaluar nga kategoria profesionale në atë të kategorisë së mesme drejtuese.

Tutje, lidhur me shqyrtimin e pretendimeve ankimore të ankuesit për ndërmarrjen e të gjitha veprimet ligjore në kuptim të nenit 66 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, ashtu që të njëjtit përmes një procesi të ligjshëm të rregullohet statusi i tij, duke e sistemuar në pozitë ekuivalente me Akt emërimin e datës 09.07.2012, Kolegji i Këshillit analizoi dispozitat e nenit 38, paragrafit 1, 2, 3, 4 dhe 6, ku përcaktohet se: 1. Pozitat në shërbimin civil grupohen sipas kategorisë, klasës, kualifikimit dhe natyrës së pozitës. 2. Pozitat në shërbimin civil ndahen në këto kategori: 2.1. Kategoria e lartë drejtuese që përfshin: sekretaren/in e përgjithshëm, drejtorin/i në përgjithshëm në agjenci të pavarur dhe rregullatore, drejtorin/in ekzekutiv dhe zëvendësdrejtorin/in e një agjencie ekzekutive, si dhe pozitat e barasvlershme me to; 2.2. Kategoria e mesme drejtuese që përfshin pozitën e drejtores/it të departamentit dhe pozitat e barasvlershme me të; 2.3. Kategoria e ulët drejtuese që përfshin pozitën e udhëheqëses/it të divizionit dhe pozitat e barasvlershme me të; 2.4. Kategoria e specialistëve që përfshin profesionistë në fusha që kërkojnë përgatitje specifike; dhe 2.5. Kategoria profesionale që përfshin zyrtarët profesional. 3. Secila nga kategoritë e përcaktuara në paragrafin 2. të këtij neni përfshin një apo më shumë klasa, në bazë të nivelit të ndryshëm të kompleksitetit të punës dhe kërkesave të përgjithshme si njohurive, aftësive dhe cilësive të nevojshme për kryerjen e punës. 4. Çdo pozitë e shërbimit civil klasifikohet si pjesë e një klase të caktuar në bazë të përshkrimit të detyrave të punës. 6. Qeveria, me propozim të ministrisë përgjegjëse për administratë publike, me akt nënligjor, miraton: 6.1. klasën e zbatueshme për secilën kategori dhe emërtimet e pozitave për çdo klasë; 6.2. grupet e administrimit të veçantë; 6.3. përshkrimin e përgjithshëm të punës për çdo kategori, klasë dhe grup, duke përfshirë kërkesat e përgjithshme për pranimin në çdo kategori, klasë dhe grup; 6.4. rregullat, procedurat, standardet dhe metodologjinë për vlerësimin dhe klasifikimin e një pozite të caktuar në një klasë apo grup të caktuar, sipas këtij neni., dhe se në këtë kuptim klasifikimi i një pozite të caktuar të shërbimit civil, bëhet në pajtim me legjislacionin në fuqi për zyrtarët publik dhe Rregulloren Nr.06/2024 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, e aplikueshme nga data 28.02.2024, e cila sipas nenit 34, ka përcaktuar se: *Obligohen institucionet në fushën e veprimit të kësaj Rregulloreje të përgatisin klasifikimin dhe grupimin e pozitave të punës në pajtim me këtë*

*Rregullore dhe katalogun e vendeve të punës, jo më vonë se tre (3) muaj nga hyrja në fuqi e kësaj Rregulloreje.*

Rrjedhimisht, Kolegji i Këshillit, nga analizimi i shkresave të lëndës, ka gjetur se organi i punësimit, gjegjësisht Agjencia e Metrologjisë së Kosovës, përmes Vendimit Nr.619/2023, të datës 15.12.2023, të Kryeministrit të Republikës së Kosovës, ka të miratuar Rregulloren (ZKM) Nr.09/2023 për Organizmin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës të Agjencisë së Metrologjisë së Kosovës, mirëpo ende nuk e ka përfunduar procesin e klasifikimit të vendeve të punës për nëpunësit civil në kuadër të këtij institucioni sipas kësaj rregulloreje, ngase sipas shkresave të lëndës të dorëzuara nga Njësia Përgjegjëse e organit përkatës të punësimit, rezulton se rregullorja e sapo theksuar është në proces të plotësim-ndryshimit pas miratimit të Rregullores Nr.06/2024 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil.

Andaj, Kolegji i Këshillit, vlerëson se vetëm pas përfundimit të procesit të klasifikimit të pozitive të punës nga organi përkatës i punësimit, sipas procedurës së theksuar më lart, ankuesit do t'i lindë e drejta e kundërshtimit me ankesë për klasifikimin e pozitës së tij të punës, ndërsa Vendimi me Ref.02/Nr.43, të datës 21.02.2025, i U.D Sekretares së Përgjithshme të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, është i pa ligjshëm në kuptim të nenit 52 paragrafit 1.5 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ngase është nxjerrë në kundërshtim me nenin 35 paragrafin 1 dhe 2 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, ndaj si rrjedhojë Kolegji i Këshilli vendosi të shfuqizoj të njëjtin si në pikën II të dispozitivit të këtij vendimit.

Kështu që thënë si me sipër dhe në mbështetje të nenit 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1, si dhe nenit 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nenin 132 paragrafi 4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm, mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**Lënda me numër A.nr.478/2025**

**Atdhe GASHI**

**Procesmbajtës**

**Malsore GASHI-BAJRAKTARI**

**Kryetare e Kolegjit**

**Vendimi i dorëzohet:**

- Përfaqësuesit të autorizuar të ankuesit, ;
- U.D Sekretares së Përgjithshme dhe U.D Udhëheqëses të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë; si dhe,
- Arkivit të KPMSHCK-së.